

STATUTI I SHOQERISE "ARIA - 21 " shpk

Ligji i aplikueshem eshte ligji nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" ne Republiken e Shqiperise.
Statuti eshte statuti i shoqerise.

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1

Data e themelimit,emri,Themeluesit

Sot,me date 18/11/2021, ne, themeluesit kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin "ARIA - 21" Shpk.
Themeluesit e shoqerise jane :

-Duilio Talvacchia	50 %
-Brisida Gega	25 %
-Elion Berdica	25 %

Neni 2 Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

- Import dhe eksport te mallrave industriale dhe ushqimore me pakice dhe me shumice
- Prodhim dhe tregetim i konfeksioneve te ndryshme, veshje pune, veshje luksi, etj.
- Prodhimi i veshjeve per femije edhe te rritur, fasoneri
- Aktivitet ne fushen imobilare dhe sherbime te ndryshme.
- Kurse per formimin profesional
- Aktivitet ne fushen e turizmit dhe te hotelerise,bar, restorant, qendra trajnimi,etj
- Trasnsport i te gjitha llojeve te mallrave industriale,ushqimore dhe bujqesore me pakice dhe me shumice si brenda edhe jashte Shqiperise.

Neni 3 Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete deri me 10 (dhjete) vjet.
Ky afat edhe mund te ndryshoje me vendimin e ortakeve te shoqerise.



**Neni 4
Selia**

Selia e shoqërise ndodhet ne adresen : Autostrada Tirane - Durres km 29, fshati Vrrin,
Njesia Administrative Rashbull, Durres
Adresa e komunikimit Tel: 00355 694007048

**KREU II
Kapitali**

**Neni 5
Kapitali fillestar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërise do te jete 1.000.000 leke (njemilion leke) e ndare ne trekuota:

Pjesmarrja e themeluesve ne kapitalin themeltar fillestar do te jete:

-Duilio Talvacchia	500000 leke	1 kuote	50 %
-Brisida Gega	250000 leke	1 kuote	25 %
-Elion Berdica	250000 leke	1 kuote	25 %

**Neni 6
Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit**

Zmadhimi i kapitalit te shoqërise mund te behet nepermjet nënshkrimeve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente te nje eksperti te autorizuar sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnjë rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e shoqërise.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendimin ne te njëjtat kushte qe kërkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogëlimi i kapitalit prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjesëve te kapitalit qe perfaqesojne.

**Neni 7
Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqërie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo mund te kalohen nepermjet:

- Kontributit ne kapitalin e shoqërise
- Shitblerjes
- Dhurimit
- Trashegimise
- Çdo menyre tjeter e parashikuar ne ligj

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme nepermjet trashegimise.

KREU III
ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi vendimarrës

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhteme;

1. Për përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
2. Ndryshimin në statut
3. Emerimin dhe shkarkimin e administratorëve
4. Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar
5. Përcaktimin e shpërblimit për personat të përmendur në pikat 3 dhe 4
6. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët ,përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
7. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
8. Zmahimin dhe zvoglimin e kapitalit
9. Pjestimi në kuotave dhe anulimin e tyre
10. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
11. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjes së asamblese
12. Çështje të tjera të parashikuara nga statuti dhe ligji

Ortaku mund të përfaqësohet në asambletë të përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo një person i tretë.


Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asambletë të përgjithshme

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblese të përgjithshme ,e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese në rast se janë me të njëjten rend dite.

Neni 9
Menyra e thirrjes së Asamblese të Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet njoftimit me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.

Njoftimi i shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe të dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblese.



Neni 10 Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve , qe kerkojne nje shumice te zakonshme,asambleja e pergjitheshme mund te marri vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 50 % te kuotave .

Ne rast se asambleja e pergjitheshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare",ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave , jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" .

Ne rast se asambleja nuk mund te mblidhet per shkak te mungues se kuorumi te permendur me lart asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njëtin rend dite.

Neni 11 Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjitheshme vendos me tri te katërtat e votave te zotëruesve te kapitalit,te ortakeve pjesmarres,per ndryshimin e statutit,zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit te rregjistruar,shpërndarjes se fitimeve,riorganizimin dhe prishjes se shoqerise.

Asambleja e pergjitheshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres , per ceshtje te tjera si:

1. Përcaktimi politikave tregtare te shoqerise
 2. Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
 3. Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve te autorizuar
 4. Përcaktimin e shpërblimeve
 5. Mbikëqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,perfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe përgatitjen e raporteve te ecurise se shoqerise.
 6. Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
 7. Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjes se asamblese
- Çdo ndryshim statut duhet te paraqitet ne QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12 Perjashtimi nga e drejta e votes

I-Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjitheshme merr vendim per :

1. Vlerësimin e veprimtarise se tij
2. Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
3. Ngritjen e ndonje padie ndaj tij nga shoqëria
4. Dhënien ose jo te përfitimeve te reja



II-Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar,i autorizuari vlerësohet te jete ne te njejtën konflikt interesi,ashti si dhe ortaku, te cilin e perfaqeson.

Neni 13 Administrimi

Asambleja e përgjithëshme emeron administrator te shoqerise Z. Elion Berdica, i biri Shuajpit, lindur me 24.12.1983, ne Shkoder dhe banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit I31224040W.

Afati i emerimit eshte 5 vjet,me te drejte perseritjeje duke filluar ky afat sot, me date 18.11.2021.

Emerimi i administratorit prodhon efekte pas rregjistrimit ne QKR

Neni 14 Kompetencat e administratorit

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

1. Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise se shoqerise,duke zbatuar politikat tregtare,te vendosura nga asambleja e pergjithëshme.
2. Perfaqeson shoqerine tregtare
3. Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabël te shoqerise
4. Pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor,bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise dhe se bashku me propozimet per shpërndarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumente përpara asamblese per miratim
5. Krijon nje sistem paralajmërimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarëvajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
6. Kyen rregjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme sic kërkohet nga ligji per QKR
7. Raporton përpara asamblese per zbatimin e politikave tregtare
8. Kryen detyra te tjera te caktuara ne ligj dhe ne statut

Administratori eshte i detyruar te therrasi asamblene e pergjithëshme ne rastet kur:

1. Sipas bilancit vjetor apo raporteve financiar te ndermjeteme rezulton se ekziston rreziku se aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve te fundit.
2. Shoqeria propozon te shese apo te disponoje nje menyre tjeter aktive te cilat kane nje vlere 5% me te larte se vlere e aseteve te shoqerise qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara
3. Shoqeria brenda dy viteve te para pas rregjistrimit te saj , propozon te bleje nga nje ortak pasuri qe kane vlere me te larte se 5% te aseteve te shoqerise qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara

Asambleja e përgjithëshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shberblimin e administratorit, ne baze te marrdhenieve kontraktore me shoqerise rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15
Pergjegjesite e administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise apo ndaj te treteve,per shkelje te ligjeve,per shkelje te statutit,apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marrëveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise , i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marrëveshjen per te përballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

KREU IV
Viti financiar-ekspertet

Neni 16
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti I pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17
Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

KREU V
Prishja-riorganizimi i shoqerise

Neni 18
Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) Kur mbaron kohezgjatja e eparashikuar ne themelimin e saj;
- b) Me vendim te Asamblese se Ortakeve
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d) Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";



e) Me vendim te gjykates

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo document te nxjerre pre tij emrin e likuidatorit dhe emertesenshtese "Shoqeri ne likuidim e siper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, Brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person I interesuar mund t'I drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 19 Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 20 Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e lejislationit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjetër specific ne Republikën e Shqiperise.

Neni 21 Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statute, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Rrethit Gjyqesor Tirane.

ORTAKET E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ARIA 21" SHPK PERFAQESUAR NGA:

DUILIO TALVACCHIA

Duilio Talvacchia



BRISIDA GEGA

Brisida Gega



ELION BERDICA

Elion Berdica

